

RELACION

Mbi Ecurinë Financiare Buxhetore të AMSHC-së për 3-mujorin e katërt të vitit 2012

Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile, në mbështetje të Ligjit nr. Nr. 10 487, dhe datë 5.12.2011 "Per buxhetin e shtetit për vitin 2012", Udhezimit nr. 2 datë 6.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimin te buxhetin" dhe Udhezimit nr.2/1 datë 15.02.2012 "Per zbatimin e buxhetin e shtetit për vitin 2012", i është akorduar një fond i planifikuar prej **94 milione e 852 mijë lekë**, i cili përbehet nga:

Fondi i Pagave:	10,189,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	1,703,000 Leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	4,000,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	76,900,000 Lekë (zeri 604)
Fondi per Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individet:	60,000 Lekë (zeri 606)
Fondi per Investimet e Trupezuara:	2,000,000 Lekë (zeri 231)

Nga fondi i pergjithshem buxhetor, per periudhen e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore në 5,290,851 leke nga totali prej 94.852.000 Leke ose **5.6%**, të fondit të planifikuar vjetor.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim te strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe te VKM Nr. 55 Date 26.01.2011 "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE".

Nga fondi i pergjithshem i pagave dhe shperblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, per këtë periudhë, është realizuar respektivisht;

2,588,378 Lekë (zeri 600) për paga, realizimi **25.4%**.

416,990 Lekë (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore, realizimi **24.5%**.

Fondi per shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), per vitin 2012, në fillim ishte planifikuar ne vlerën 7,000,000 leke, por duke pare nevojën e Institucionit per fonde per OJF, i cili eshte dhe misioni kryesor i AMSHC, ky ze u reduktua me 3,000,000 lekë, pra vlera e re e

ketij zeri eshte 4,000,000 lekë. Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **457,982 Lekë** ose **11.45%** e planit vjetor.

Gjithashtu, në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, uje, shërbime postare e telefonike falas për publikun, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevojat të AMSHC, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, etj.
- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitore dhe të treta, të mbartura nga 2011.

Fondi në zerin për Transferime Korrente të Brendshme (zeri 604), për vitin 2012 ishte planifikuar në vlerën 73,000,000 leke por u shtuan në 76,900,000 leke. Ky është dhe zeri me më shumë në strukturën e buxhetit të AMSHC, duke qenë se dhe vetë misioni i këtij institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grantë për projektpropozimet të OJF përfituese.

Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **5,290,851 Lekë** ose **6.89%**, e planit vjetor.

Në realizimin e këtij zeri, AMSHC ka vazhduar me disbursimet për kështin e parë dhe të dytë (50% dhe 40%) e thirrjes së tretë dhe me kështet e mbetura të Grantëve të miratuara dhe të kontraktuara të thirrjeve të mëparshme për OJF.

Fondi për shpenzim investime (zeri 231) ,

2,000,000 Lekë (zeri 231) për Investime të Trupezuara. Për periudhen respektive është realizuar vlera prej **157,500 Lekë** ose **7.88%**, e planit vjetor.

AMSHC, ka zbatuar me korrektesë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbeshtetjen e Shoqërisë Civile", si dhe legjislacionin administrativ-financiar shqiptar.

Drejtor Ekzekutiv

RUDI BOBRATI